



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2851/2 prot.

Gramsh, më 09/08/2022

VENDIM

Nr. 61 dt. 31/08/2022

PËR

“Për ndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile, për bashkinë Gramsh, për vitin 2022”.

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 65 të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr. 414 datë 8.7.2021 “Për miratimin e proedurave dhe kriterëve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”; VKB Nr. 127 datë 29.12.2021 “Për miratimin e programit buxhetor të Bashkisë Gramsh, për vitin 2022” si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile;Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e datës 31.08.2022:

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të fondit të Mbrojtjes Civile prej **7 282 512 (shtatë million e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë** në shpërndarjen e tij për ndërtimin e urës së Kushovës, Njësia Administrative Kushovë, bashkia Gramsh.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave, Zhillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, dhe Sektori i Emergjencave Civile .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

XHULIA GJINI

GRETA LENA

Konceptoi: Xh. Gjini
Pranoi: G. Lena
Miratoi: G. Lena
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes: _____

